



01/Nr. 186/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 Neni 11 , 40, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 Neni 2, dhe në bazë të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me numër Nr. 01/ 5349/ 2020 të datës 31.08.2020, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28. 01. 2021 merr:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË
HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët në Komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2020/2021.
2. Mjetet financiare të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere vlere e të cilave është në shumë prej 15,000.00 €, që do të përfitojnë 30 (tridhjetë) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € në muaj.
3. Prioritetet për kuadro deficitare janë në Fakultetet:
Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, stomatologji).
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Ndërtimtari dhe i Arkitekturës).
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksiione dhe mekanizim, Komunikacion).
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Veterinari, Bioteknologji Ushqimore).
Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).
Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë Fizikë Kimi).
Fakulteti Arteve
Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

4. Bursat ndahen për studentët e vitit të dytë e lartë. Në rast të mos plotësimit të bursave nga viti i dytë e lartë, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave edhe për vitin e parë të studimeve.
Përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni i formuar nga drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport sipas rregullores për ndarje të subvencioneve.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.01.2021





01/ Nr. 172/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2021 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR KATËR KOMITETET KONSULTATIVE
PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për katër komitetet konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2021 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për komitetin konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për komitetin konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë, për komitetin konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komitetet Konsultative
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28. 01. 2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 171/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2021 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2021.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28. 01. 2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 844/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12.1, 82.2, Ligji Nr.05L-031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53, duke vepruar sipas Kërkesës së MPL-së Nr.20/2 të datës 18.01.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2021 merr:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01/Nr.9228/2020 PËR NDËRRIM DESTINIM TË
TOKËS BUJQËSORE

1. Me këtë Vendim, Shfuqizohet Vendimi i Kuvendi i Komunës 01/Nr.9228/2020 i datës 29.12.2020 për ndërrim destinim të tokës bujqësore.
2. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas kërkesës së MPL-së të datës 18.01.2021 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Linjës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sepse i njëjti bie ndesh me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinorë të Kosovës.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Bujqësi,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28. 01. 2021

